



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS DYTËSORE
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DHE DYTËSORE

Nr. 1908/Prot.

Tiranë, më 14.10.2025

NJOFTIM PUBLIK

**“PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR ZNJ.
ESMERALDA GJURA NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 2791, DATË 09.05.2025, TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË”**

Rruga “Ymer Sallaku” Ndërtesa 19, Hyrja 1, Nësia administrative nr.8, Tiranë
Cel: 0695476863

Me Vendimin nr.2791, datë 09.05.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në procesin me palë paditëse znj. Esmeralda Gjura (referuar vendimit nr. 771, datë 31.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është përfituese e Ndihmës Juridike Dytësore) dhe të paditur z. Lirim Nexhipi me objekt: “Autorizimin e daljes jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë, së fëmijëve të mitur Arsel Nexhipi i datëlindjes 28.03.2016 dhe Rrapo Nexhipi i datëlindjes 10.01.2018, vetëm në pani të nënës së tyre Esmeralda Gjura, pa pëlqimin paraprak të babait të tyre, të paditurit Lirim Nexhipi”, ka vendosur:

Pushimin e gjykimit;

Në vendim gjykata shpreh që paditësja nuk u paraqit edhe pse kishte dijeni për gjykimin me fletëthirrje datë 05.02.2024.

Në zbatim të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” konkretisht në nenin 31 citohet që:

1. Në rast se një person, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rrethanat në një mënyrë të tillë që nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i njofton përfituesit të ndihmës juridike detyrimin për kthimin vullnetar të shpenzimeve të kryera, shumën konkrete dhe afatin për përmbushjen e këtij detyrimi. Procedura, periodiciteti dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.
2. Në rast të mosekzekutimit vullnetar të detyrimit për kthimin e shpenzimeve brenda afatit të caktuar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, do të zbatohen dhe në rastin kur personi, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore ose avokati i caktuar:

a) nuk e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë, pas kalimit të një afati tremujor nga data kur vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore ka marrë formë të prerë;

b) ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, nga e drejta e padisë, nga ankimi dhe rekursi apo nga ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit.

Referuar nenit 299 të Kodit të Proçedurës Civile gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit duke qenë se znj. Esmeralda Gjura nuk është paraqitur në seancë, si dhe ka bërë kërkesë me shkrim për pushimin e gjykimit.

Për sa më sipër, ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të shumës prej 15.000 lekë, të paguara nga ana jonë për shpërblim avokati.

Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas më NIPT L11704452P.

Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me znj. Esmeralda Gjura. Në këto kushte referuar nenit 148 e në vijim të Kodit të procedurës Administrative kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Nësinë Administrative nr.8, Bashkia Tiranë, si dhe në faqen web të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë.

Njoftimi quhet i bërë kur Bashkia Tiranë depoziton në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
NË MUNGESË**

**(DREJTOR I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT
TË NDHIMËS PARËSORE)**

Patricia Rogace

